MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË NJËSINË E MENAXHIMIT TË PROJEKTIT "MENAXHIMI I INTEGRUAR I UJËRAVE DHE EKOSISTEMIT" ÇERTIFIKIM I LLOGARIVE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve, Tiranë, Njësia e Menaxhimit të Projektit "Menaxhimi i integruar i ujërave dhe ekosistemit" çertifikim i llogarive, me objekt "Mbi vlerësimin e parimeve të përdorura për kontabilitetin dhe çmuarjet e bëra nga menaxhimi, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare" për periudhën nga fillimi i projektit deri 30.06.2012, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 27 datë 05.03.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 344/5, datë 05.03.2012, dërguar Z. [redacted], Drejtor i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizimeve, Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masat e nevojshme, që me përfundimin zyrtar të projektit të bëhet kalimi në pronësi të bashkive respektive të aseteve, për të siguruar administrimin dhe mirëmbajtjen e tyre, trajtuar në faqet 3 dhe 12-13 të Raportit Final të Certifikimit.

Brenda datës 30.12.2012

2. Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa që në përputhje me legjislacionin shqiptar, për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, si dhe pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore të bëhet nga i punësuari dhe në asnjë rast të mos përdoren fonde nga burime të tjera, trajtuar në faqet 7-8 dhe 13-14 të Raportit Final të Certifikimit.

Vazhdimisht

3. Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masat e nevojshme që në të gjitha rastet e kryerjes së shpenzimeve, ato të shoqërohen me dokumentacionin mbështetës si mandat-pagesa, si dhe të jenë të konfirmuara nga Drejtuesi i projektit dhe financieri, mbështetur në faturat e shitësit, trajtuar në faqet 8-9 dhe 15-16 të Raportit Final të Certifikimit.

Në vazhdimësi

4. Njësia e Menaxhimit të Projektit, së bashku me aktorët e tjerë të përfshirë në projekt, të marrë masat e nevojshme që realizimi i prokurimeve për investime, fillimi dhe përfundimi i zbatimit të kontratave, pa pësuar ndryshime të qenësishme të bëhen sipas afateve të përcaktuara në Dokumentin e Vlerësimit të Projektit, trajtuar në faqet 9-11 dhe 15-18 të Raportit Final të Certifikimit.

Në vazhdimësi

B. MASA PER SHPËRBLIMIN E DËMIT

1. Mbështetur në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 13 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat për 11.2% të kontributeve shoqërore në shumën 8,007 euro, si dhe në zbatim të nenit 8 të kreut të dytë të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", për pagesën e 10 % tatim mbi të ardhurat nga punësimi, për 2,402 USD, gjithsej 10,409 USD për personat përgjegjës: [redacted] sipas listë-pagesave përkatëse, trajtuar më hollësisht në faqet 7-9 dhe 13-15 të Raportit Final të Certifikimit.

C. MASA DISIPLINORE

Drejtuesi i projektit të nisë procedurat për dhënien e masës disiplinore **"Vërejtje"** për**:**

1. [redacted] me detyrë arkëtare pasi:
ka kryer pagesa të ndryshme të pashoqëruara me dokumentacionin bazë, si dhe të pakonfirmuara nga Drejtuesi i Projektit dhe Financieri**,** në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, trajtuar më hollësisht në faqet 8-9 dhe 15-16 të Raportit Final të Certifikimit.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Gjovalin Preçi**,** Nikolin Gjonaj**,** Teuta Qatipi, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT.